

Klarenc Xhaferaj ka lindur më 19 korrik 1982, në qytetin e Vlorës.

Z.Xhaferaj ka përfunduar studimet e larta, në fushat e Ekonomisë dhe Drejtësisë pranë Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë dhe në vitin 2013 ka përfunduar kualifikimin e Ekspertit të Vlerësimit mbi Pasuritë e Paluajtshme pranë Universitetit Politeknik të Tiranës.

Ai gëzon një eksperiencë administrative rreth 15 vjeçare në fushën e kontrollit dhe auditimit nga të cilat mbi 10 vite pranë administratës tatimore dhe 4 vite në veprimtarinë audituese pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit. Z.Xhaferaj është angazhuar edhe në rolin e trenerit për administratën tatimore sa i përket zbatimit të legjislacionit tatimor.

Gjatë karrierës së tij profesionale ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme brenda vendit mbi çështjet fiskale, luftës kundër pastrimit të parave, parandalimit të konfliktit të interesit etj, si dhe në një sërë konferencash ndërkombëtare me institucionet homologe të KLSH.

Prej vitit 2018 ai ka ushtruar pranë KLSH funksionin e Kryeaudituesit në Departamentin e Auditimit të Buxhetit të Shtetit, Institucioneve Qendrore, dhe aktualisht pranë Departamentit të Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja ku mbulon njëkohësisht dhe detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Auditimit të Investimeve të Huaja në këtë departament.

Z.Xhaferaj është njohës shumë i mirë i gjuhës angleze dhe italiane.